

RESURSET GJENETIKE BIMORE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Bujqësisë
Titulli i lëndës:	Resurset gjenetike bimore
Niveli:	Msc
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	10:00- 11:20/ Fakulteti Bujqësisë,
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Sali Aliu
Detajet kontaktuese:	sali.aliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Lënda ka si detyre kryesore të informoj studentet për rolin e bimëve dhe variacionin gjenetik të tyre, domestifikimin e bimëve, llojet e domestifikuara, të egra, populacionet lokale, landracet, mutacionet dhe shfrytëzimi i tyre në programe të përmirësimit gjenetik për krijim të linjave apo hibrideve të reja. Rolin e ekspeditave në teren, kolektimi, grumbullimi, evaluimi, karakterizimi i këtij materiali dhe vendosja e tyre në banka të gjeneve. Ruajtja in situ, ex situ, në farm, etj
Qëllimet e lëndës:	Parimet kryesore të lëndës do të jenë me fokus që të analizohen Resurset Gjenetike Bimore mundë të jenë nga burime të ndryshme, por ato ndahen në disa grupe: Bimë të Kultivuara Varietete komerciale Varietete tradicionale ose lokale të cilat njihen me një emër Landrace. Linjat inbrede, Materiali gjenetik Special. Format (speciet) e egra. Bime mutante të cilat mundë të shkaktohen nga ndikimi i mutacioneve spontane të cilat ndodhin në natyrë ose atyre të indukura. Në grupin tjetër sistemohen produktet e hibridizimit inter-specifik si dhe produktet trasgjenike. Shumë varietete janë me përmbajtje të lartë të lizininës 3-4 %. Si të tilla janë të shkëlqyeshme si material gjenetik në seleksionim. Variabiliteti gjenetik i bimëve të kultivuara nuk është i shpërndarë në mënyrë uniforme në të gjitha rajonet e botes dhe kjo shpërndarje nuk është e rastësishme. Me shumë se 96% e bazës gjenetike të bimëve që përdoren për ushqim ndodhen në rajone me pak të zhvilluara të botes. Diversiteti është i pranishëm në të gjitha nivelet e jetës, nga gjenet deri të ekosistemet. Diversiteti ndikohet shumë nga puna e njeriut (Hibridizimi,

	mutacionet). Termat variacion, variabilitet, ndryshueshmëri janë terma ekuivalent që shprehin larminë e veçorive të dallueshme për një lloj bimor apo mes tyre. Baza e variabilitetit qëndron në mekanizma gjenetik (mutacione, hibridizim, rekombinimet, transferi i gjenit). Diversiteti shkaktohet si rezultat i bazës gjenetike dhe faktorëve mjedisore		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pritjet janë që studentet të janë në gjendje të njohin rolin dhe rëndësinë e lëndës, metodat, teknikat dhe strukturën e funksionimit të bankës gjenetike bimore duke përfshirë, kolektimin, ruajtjen dhe grumbullimin e materialit gjenetik bimor, ekspeditat të organizuara në lokalitete të ndryshme.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënimit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	4	8
Ushtrime në teren	2	2	4
Kollokfiime,seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanake të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	4	1	8
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime në kombinim me mësimet interaktive. Verifikimi i dijes do të kryhet me test pas përfundimit të ciklit mësimor. Pas përfundimit të mësimin është i obligueshëm kolokviumi nga pjesa praktike dhe provimi përfundimtarë me gojë		
Metodat e vlerësimit:	Pyetësori, caktohet nga profesori sipas orarit të performancës së kursit mësimor.		

	<p>Vlerësimi Test: Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë: 30% Detyrat dhe angazhime tjera: 5% Vijimi i rregullt: 5% Provimi përfundimtar: 30% Total 100%</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Aliu S. 2012. Ligjerata nga Resurset gjenetike bimore, Prishtine Milton and Pohelman. 1995. Breeding for field Crops. ISU.</p>
Literatura shtesë:	<p>Allard RW. 1970. Population structure and sampling methods. Pages 97–107 in Genetic resources in plants –their exploration and conservation. (Frankel OH and Bennett E, eds.). IBH Handbook No. 11. Oxford, UK: Blackwell Scientific. FAO. 1998. The state of ex situ conservation. Page 90 in The state of world's plant genetic resources for food and agriculture. Rome, Italy: Food and Agriculture Organization of the United Nations. Hamilton SH, Engles JMM and van Hintum T. 2003. Considerations for improved conservation and utilization concepts and strategies. Pages 43–59 in A guide to effective management of germplasm collections (Engles JMM and Visser L, eds.). IPGRI Handbooks for Genebanks No. 6. Rome, Italy: International Plant Genetic Resources Institute</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Roli dhe rëndësia e bimëve dhe resurseve gjenetike bimore
Java e dytë:	Domestifikimi i bimëve dhe klasifikimi i tyre
Java e tretë:	Origjina e bimëve bujqësore dhe variabiliteti gjenetik
Java e katërt:	Llojet bimore si burim i variacionit gjenetik
Java e pestë:	Burimet e variacionit gjenetik
Java e gjashtë:	Populacionet lokale
Java e shtatë:	Testi për vlerësues
Java e tetë:	Materiali specifik në resurset gjenetike bimore
Java e nëntë:	Identifikim dhe grumbullimi i materialit gjenetik, ekspeditat në terren
Java e dhjetë:	In situ konservimi
Java e njëmbëdhjetë:	On farm konservimi
Java e dymbëdhjetë:	Ex situ konservimi

Java e trembëdhjetë:	Deskriptoret e bimëve bujqësore
Java e katërbëdhjetë:	Bankat gjenetike bimore , Erozioni gjenetik, protokollet për resurse gjenetike bimore
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi dyte vlerësues

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> - vijim i rregullt në ligjërata dhe ushtrime - rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim - hyrja në sallë me kohë, - shkyçja e telefonave celular